



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju

Kosovo Accreditation Agency



Data: 11.08.2017

Ref.: 7031/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht kërkesa nr.583/17, datë 21.07.2017 e BPrAL Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli" për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr.570/17, datë 06.07.2017.
- II. Hiqet masa e pezullimit të akreditimit sipas vendimit nr.570/17, datë 06.07.2017 për programin e studimit të BPrAL Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli":
 - Inxhinieria e Trafikut dhe Transportit Rrugor, BA, 180 ECTS.
- III. Lejohet regjistrimi i studenteve në programin e cekura në pikën dy të këtij vendimi.
- IV. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së nr.570/17, datë 06.07.2017 mbetet e pa ndryshuar.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli" me 21.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr. 570/17, datë 06.07.2017, me të cilin vendim BPrAL Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli" i është pezulluar akreditimi për programet e studimit: Trafiku Hekurudhor dhe Transporti, BA, 180 ECTS; Trafiku Ajror dhe Transporti, BA, 180 ECTS; Logjistika dhe Transporti, BA, 180 ECTS; Inxhinieria e Trafikut dhe Transportit Rrugor, BA, 180 ECTS; Inxhinieri Postare dhe Telekomunikacioni, BA, 180 ECTS; Transport dhe Telekomunikacion, Diplomë Profesionale e nivelit 7 sipas KKK, 120 ECTS.


Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga BPrAL Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli", është konstatuar që programi i cekura në pikën dy të këtij vendimi, akreditimi i të cilit është pezulluar me vendim të KSHC-së nr.570/17, datë 06.07.2017, tani i plotësojnë kushtet sa i përket stafit akademik që parashihen me Udhëzimin Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, nenit 11, pika 3.2.

Bazuar në dispozitat e cekura me lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2017, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

